

## ZJARRET NË PYJE

-----

Sot pasdite (e diel, dt. 21) dhe nesër (e hënë, dt. 22) pritet nivel "I MODERUAR" në qarqet Shkodër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier dhe Berat, ndërsa në qarqet e tjerë pritet nivel rrezik "I ULËT" (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

Në disa qarqe pritet nivel rrezik lokalisht "I LARTË" konkretisht: qarku Shkodër (Jug), Lezhë (Veri - Lindje), Durrës (Lindje), Elbasan (Perëndim).

Rreziku pritet të jetë më i lartë gjatë ditës së sotme.

## PARASHIKIMI METEO

-----

### RESHJET

Sot pasdite (e diel, dt. 21) nuk priten reshje ndërsa nesër (e hënë, dt. 22) priten reshje lokalisht mesatare në qarqet Dibër dhe Korçë të shoqëruara me shtrëngata ndërsa në qarqet e tjera priten reshje të dobëta (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

### TEMPERATURA

Nesër (e hënë, dt. 22) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 22 / 33 °C

në vendet e ulëta: 17 / 36 °C

në vendet malore: 14 / 30 °C

### ERA

Sot pasdite (e diel, dt. 21) dhe nesër (e hënë, dt. 22) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare.

**NIVELET E RREZIKUT**



**S'KA RREZIK**

**I ULËT**

**I MODERUAR**


**I LART**

**PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)**

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	I MODERUAR	të dobëta					
KUKËS	I ULËT	të dobëta					
DIBËR	I ULËT	të dobëta	mesatare				
LEZHË	I MODERUAR	të dobëta					
DURRËS	I MODERUAR	të dobëta					
TIRANË	I MODERUAR	të dobëta					
ELBASAN	I MODERUAR	të dobëta					
FIER	I MODERUAR	të dobëta					
BERAT	I MODERUAR	të dobëta					
KORÇË	I ULËT	të dobëta	mesatare				
VLORË	I ULËT	të dobëta					
GJIROKASTËR	I ULËT	të dobëta					

**LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe**

<b>Niveli i Rrezikut</b>	<b>Reshje shiu</b> (mm / 24 orë)
<b>S'KA RREZIK</b>	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
<b>I ULËT</b>	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
<b>I MODERUAR</b>	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
<b>I LARTË</b>	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.



**RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 21–22.**

**LEGJENDA: Zjarre në pyje**

<b>S'KA RREZIK</b>	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
<b>ULËT</b>	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
<b>I MODERUAR</b>	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
<b>I LARTË</b>	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

**SIMBOLE**

	Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmybtje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmybtje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke